# DËSHMI ARKIVI

**A-468817**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Zbulimi tronditës në një varrezë mesjetare në Itali, nëna gjendet e përqafuar me fëmijën e saj |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/25/zbulimi-trondites-ne-nje-varreze-mesjetare-ne-itali-nena-gjendet-e-perqafuar-me-femijen-e-saj/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 12:31:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 12:25:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 12:24:00 UTC → 25 shtator 2026, 12:26:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5f7614f66a052dd6fb341d325cf65cf03fc4620ccc9ee01d46acd5553395e4fd` |
| TEKSTI | `3f0f3d9c3205cfcc5dab6fe11e3ac81eaf5003883b54038caf62c580f8f2ce86` |
| PAMJA | `4c51ded53ce976d9ef78ad417e01e61a95d4c9ce4c8559ab1b073197d9112c2f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `96b217c73b41cba5a5d29bdb790a21ca643727fd1f29024e82c5cda19f74110c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7ef11613d0a46fe814f564609ee7439753917635a3984a70b661e478103337ad` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/96b217c73b41cba5a5d29bdb790a21ca643727fd1f29024e82c5cda19f74110c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

# Zbulimi tronditës në një varrezë mesjetare në Itali, nëna gjendet e përqafuar me fëmijën e saj

25/09/2026 14:25



**Një zbulim arkeologjik i rrallë dhe veçanërisht prekës është bërë gjatë gërmimeve në zonën e Sipontos, pranë Manfredonias, në provincën e Foggias, ku arkeologët kanë zbuluar një varrezë mesjetare që daton nga shekujt XII–XIII.**

Brenda një strukture murature rreth 30 metra të gjatë janë zbuluar rreth 30 varrime, ku shumica e individëve duket se kanë qenë të rritur. Mes tyre ndodhet edhe një varr i veçantë: skeleti i një gruaje, rreth 30–40 vjeç, e cila duket se e kishte mbajtur të shtrënguar në krah fëmijën e saj të vogël.

Sipas arkeologëve, fëmija besohet të ketë qenë rreth 4–5 vjeç. Pozicioni i eshtrave sugjeron se nëna e kishte përqafuar me krahun e djathtë, duke krijuar një skenë që ka mbijetuar për rreth tetë shekuj.

Zbulimi u bë publik nga ArcheoSipontum, ndërsa arkeologu Giuliano Volpe, profesor në Universitetin e Barit, tha se identifikimi i saktë i moshës dhe gjinisë së fëmijës do të përcaktohet pas analizave antropologjike dhe studimit të eshtrave.

"Do të kryejmë analiza të hollësishme mbi eshtrat dhe studime antropologjike për të përcaktuar me saktësi datimin dhe, mbi të gjitha, për të kuptuar nëse bëhet fjalë për një djalë apo një vajzë", tha Volpe.

Gërmimet kanë nisur rreth tre javë më parë në zonën e portit antik të Sipontos dhe po zhvillohen nga studiues të universiteteve të Barit dhe Foggias, së bashku me studentë të tyre. Në ekspeditë marrin pjesë edhe nxënës të liceut "Scacchi" të Barit, në kuadër të aktiviteteve të praktikës.

Arkeologët do të vijojnë punën në terren për të zbuluar nëse pranë varrezës ka pasur edhe një ndërtesë kulti. Për momentin, studiuesit po shqyrtojnë disa hipoteza mbi funksionin e strukturës dhe rrethanat në të cilat u krijua varreza.

Zbulimi pritet të marrë rëndësi të veçantë për studimin e jetës dhe riteve mortore në Siponton mesjetare, ndërsa analiza e eshtrave mund të japë të dhëna të reja për identitetin dhe historinë e kësaj nëne dhe fëmijës së saj.

**Top Channel**

## Kryesore



"Më goditi me pasqyrë, duke më rrezikuar jetën"/ Rrëfimi i shefit të Komisariatit të Krujës për videon virale ku u përfshi
14:26

Plagosja me armë në Lezhë/ Kamerat e sigurisë zbardhin konfliktin, autorët u larguan me makinë, shpallen në kërkim
09:59

Moti 'përmbys' planet e pushuesve, shiu dhe era boshatisin Lungomaren në Vlorë
10:41

Përplasje për zgjedhjet në Brazil/ 31 ligjvënës amerikanë akuzojnë administratën Trump për ndërhyrje
09:47

Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb
10:27

## Më të lexuarat

"Ku jemi katandisur!"/ Ish-deputeti Murrizi nxjerr videon e sherrit në Durrës: Ky që e rrahin si gomarin në duhan është shefi i Komisariatit Krujë

"Ke kaluar nga zyra e Ergysit që u bëre deputete?"/ Ministrja Ismaili i përgjigjet fjalës së Berishës në Kuvend: Tek Agasi isha bashkë me Argitën

"Dumani përzuri Vlorën nga zyra", Murrizi bën deklaratën e fortë në Top Story: E nxori nga qershori i 2025

Top Story/ "Kërkoi ekspertim të telefonit jashtë Shqipërisë", gazetarja Hoxha zbardh detajet nga seanca me dyer të mbyllura, çfarë deklaroi Vlora Hyseni në SPAK

"Burg, burg", një grup protestuesish përplasen me Çuçin dhe bashkëshorten në kafene, si përgjigjet deputeti i PS dhe Delina Fico

Detaje nga përplasja në rrugët e Durrësit/ Pronari i hotelit që u shemb gjatë tërmetit goditi shefin e komisariatit, si u mbyll ngjarja pa denoncim

Bllokohen specat dhe açuget/ Jo vetëm perimet, Shqipëria ka probleme edhe me produktet e detit. Bllokohen në Itali

Akuzohet për përvetësimin e 700 mijë eurove nga Posta Shqiptare, lirohet nga burgu ish-drejtoresha, Elisabeta Mataj

## Bota »







Mori pjesë në protestën kundër Netanyahut pranë selisë së OKB-së në Nju Jork, arrestohet aktorja Susan Sarandon

25/09 14:21

"Raportet tona, kurrë më të mira", Trump i dhuron Xi Jinping një shqiponjë të SHBA-së

25/09 14:12

Zhdukja e adoleshentes pa asnjë gjurmë/ Del emri i tretë në hetim, rrëfimi për telefonatën misterioze të vitit 1983

25/09 14:03




Polemika rreth librit për Princeshën Diana, i vëllai hedh akuza ndaj Mbretit Charles. Reagon Pallati Mbretëror

25/09 13:57




Zjarr i madh në një traget pranë Mykonos, evakuohen 29 persona/ Flakët nisën nga një kamion

25/09 13:39



Greqia po kthen trurin/ Përmirësimi i ekonomisë, kthehen grekët e kualifikuar që emigruan në Gjermani

25/09 13:25

"Bëra gabim që qëllova me shishe"/ Delina Fico zbulon për "Shqipëria Live" se çfarë ndodhi në incidentin me protestuesit: Kishin 5 minuta që shanin

Top Story/ "Mbrojtja do jetë arrogante", Vangjeli për deklaratën e Vlora Hysenit: Po shantazhon njerëzit me pushtet. Pretendimi i saj për Agasin, i gënjeshtërt

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News – Arrestohet aktorja Susan Sarandon / Protestoi kundër Netanjahut, pranga dhe 2 kolegeve




Top News – Sherr masiv mes adoleshentëve. Ndërhyn policia, procedohen 23 prej tyre



Top Channel/ Shpërthim i fuqishëm, shembet ndërtesa dykatëshe, plagoset një kalimtar



Top Channel/ "Gratë me funde të gjata janë nëna më të mira"! Italia zien, ja si përgjigjen deputetet



Top News – Putin dërgon avionët mbi Finlandë... / Finlanda e Suedia i gjurmojnë, mision i përbashkët



Top Channel/ Ambasadori i Bullgarisë në Pustec, Ivajlo Kiro:E drejtë që njerëzit të protestojnë

**Lajme**
Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

**Bota**
Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

**Sport**
Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

**Pop News**
Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

**Programe**
Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

**Top Channel**
Rreth Top Channel
Kontakt
Bileta – Portokalli
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.